



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:096352
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06030905

K.DH.SH.II.nr.765/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KS Siguria, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Trepça me seli ne Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP.nr.26/23 të datës 10.01.2024, me datën 07.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit KS Siguria, me seli në Prishtinë, **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP.nr.26/23 të datës 10.01.2024 dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale - Dhomës se Shkalles se Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.26/23 të datës 10.01.2024, në dispozitiv ka vendosur te ndërpritet procedura ne qështjen permbarimore te lejuar sipas Urdhrit Permbarimor P.nr. 738/15 te dates 03.12.15 nga Permbaruesi Privat Flamur S.Bogaj, per shkak te fillimit të likuidimit te detyrueshem ndaj debitorit "Trepça" me seli ne Mitrovice.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori KS Siguria, me seli në Prishtinë, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës procedurale, vërtetimit të gabuar të

gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles së Parë, pas vlerësimit të propozimit për përmbartim, ka nxjerr aktvendim KPPP.nr.26/23 të datës 10.01.2024, me të cilin ka vendosur të ndërpritet procedura në çështjen përmbartimore të lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 738/15 të datës 03.12.15 nga Përmbartuesi Privat Flamur S.Bogaj, për shkak të fillimit të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit "Trepça" me seli në Mitrovicë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Përmbartuesi Privat Flamur S.Bogaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KS "Siguria", ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 738/15 të datës 03.12.15, me të cilin ka lejuar përmbartimin mbi bazën e dokumentit fature nr.747/11 e datës 21-Shtator-11, ashtu që është detyruar debitorit "Trepça" me seli në Mitrovicë, që në emër të borxhit të papaguar nga fatura e lartcekur të paguaj kreditorit shumë prej 243.60€, me kamate ligjore si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me udhëzimin e datës 15 prill 2014, ka njoftuar Përmbartuesin Privat lidhur me njoftimin për Moratorium për Ndërmarrjen "Trepça" që është nën riorganizim të publikuar me datë 08 nëntor 2011, andaj nënkupton pezullimin e të gjitha procedurave administrative dhe përmbartimore me përjashtim të procedurave të përcaktuara në nenin 5.3 të Ligjit të Riorganizimit, ka kërkuar që pezullimi gjithashtu të përfshij të gjitha përmbartimet e aktgjykimit të formës së prere lidhur me padite monetare.

Gjykata e shkalles së parë, me qëllim të vendosjes në këtë çështje përmbartimore iu referua nenit 5.1 të Ligjit nr.04/L- 035-për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre, parashihet se "Nga data e Vendimit të Moratoriumit të gjitha veprimet, procedurat apo aktet e lloji që synojnë përcaktimin e vlefshmërisë, zbatimin apo përmbushjen e ndonjë kërkesë apo interesi ndaj Ndërmarrjes në fjale apo asete e saj do të pezullohen dhe do të vazhdojnë me lejen e gjykatës" Në ndërlidhje me këtë, me nenin 277, par. 1, pika (d) të Ligjit

për Procedurën Kontestimore (LPK) i cili gjen zbatim përshtatshmërisht në këtë çështje përmbartimore në përputhje me nenin 17 të LPP-se përcaktohet se "Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues". Referuar dispozitave të lartcekura, dhe meqenëse në shkresat e lëndës gjendet njoftimi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të debitorit "Trepça" me seli në Mitrovicë është në riorganizim, atëherë rezultojnë se procedura në këtë çështje përmbartimore në kuptim të nenit 277, pika (d) duhet të ndërpritet, kjo për faktin se duke qenë në procedurë të riorganizimit, debitorit tanimë ka marrë cilësinë e debitorit falimentues. Andaj, konform nenit 10 të shtojcës së Ligjit 04/L-034 mbi AKP-ne, nenit 17 të LPP-së në lidhje me nenin 277, pika (d) të LPK-se, gjykata vendosi si në aktvendimin e ankimuar.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkalles e Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 182 të LPK-së, me çka ka ardhur edhe deri të aplikimi i gabuar i të drejtës procedurale. Aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të paqarta shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Shkalles së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar mirë gjendjen dhe shkresat në lëndë kur ka marrë vendimin e atakuar me të cilin ka vendosur të ndërpritet procedura në çështjen përmbartimore të lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 738/15 të datës 03.12.15 nga Përmbartuesi Privat Flamur S.Bogaj, për shkak të fillimit të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit "Trepça" me seli në Mitrovicë.

Në këtë drejtim Gjykata e Shkalles së dytë nuk pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për arsye se nuk e ka vërtetuar faktin se a është ende në fuqi njoftimi për Moratorium për Ndërmarrjen "Trepça" që është nën riorganizim të publikuar me datë 08 nëntor 2011 dhe a kanë kaluar detyrimet e Ndërmarrjes Trepça nën administrimin e AKP tek Trepça sh.a. po ashtu nga shikimi në shkresat e lëndës rezultojnë se propozimi për përmbartim është iniciuar kundër debitorit Trepça Ndërmarrje nën administrimin e AKP, derisa nga shkresat e lëndës, gjykata nuk vërtetoi faktin se a është njoftuar AKP përkitazi me kërkesën e kreditorit në procedurën e përmbartimit.

Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të shqyrtoj pretendimet ankimore të palëve, e eventualisht sipas nevojës edhe duke caktuar seancë dëgjimore në kuptim të dispozitave të lartcekura.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.765/24, me datë 07.08.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**